VENDIM
Nr. 843, datë 27.9.2013

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Miratimin e misionit, të fushave të përgjegjësisë shtetërore e të organeve të varësisë së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Ministria e Arsimit dhe Sportit harton dhe zbaton politika që synojnë sigurimin e një sistemi arsimor cilësor, zhvillimin perspektiv të arsimit, respektimin e interesave të individit, të komunitetit e të shoqërisë dhe pajisjen me njohuritë e nevojshme për t'u përballur me kërkesat e ekonomisë së tregut në përputhje me përparësitë, kombëtare dhe evropiane, krijimin, transmetimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve me anë të mësimdhënies e të shërbimeve. Ministria e Arsimit dhe Sportit harton, programon, zhvillon dhe bashkërendon punën për politikat kombëtare në fushën e sportit, integrimit kulturor, harton politikat, mbrojtëse dhe promovuese, si dhe krijon hapësirat e nevojshme për zhvillimin dhe përmirësimin e sportit shqiptar.

III. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës:

1. Sektorin e edukimit parauniversitar;
2. Sektorin e arsimit të lartë;
3. Sektorin e zhvillimit të arsimit jopublik;
4. Sektorin e zhvillimit të sportit.

IV. Ministria e Arsimit dhe Sportit synon ofrimin e një edukimi cilësor në arsimin parauniversitar, arritje të standardeve bashkëkohore evropiane në arsimin e lartë, impulse konkrete në zhvillimin e sportit, si një aspekt thelbësor për konsolidimin e një shoqërie të shëndetshme.

V. Ministria e Arsimit dhe Sportit është përgjegjëse për hartimin e strategjive e të politikave të zhvillimit të një sistemi arsimor cilësor që veprojnë në sektorët e fushës së përgjegjësisë së saj. Kjo ministri mund ta ushtrojë këtë detyrë vetëm ose së bashku me ministri të tjera, sipas delegimit që i bën Këshilli i Ministrave, bazuar në legjislacionin për sistemin arsimor parauniversitar dhe atë të lartë, si dhe në legjislacionin për sportin.

VI. Në përmbushje të misionit dhe kompetencave të saj, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka organet e varësisë, si më poshtë vijon:

1. Njësitë arsimore vendore;
2. Agjencinë Kombëtare të Provimeve;
3. Inspektoratin Shtetëror të Arsimit;
4. Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë;
5. Institutin për Zhvillimin e Arsimit;
6. Qendrën e Studimeve Albanologjike;
7. Shtëpinë Botuese të Teksteve Mësimore;
8. Agjencinë e Shërbimit të Sporteve.

VII. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama